



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
KËSHILLI TEKNIK

Nr. 68 Prot.

Tiranë, më datë 26.02.2026

VENDIM
Nr. 11, datë 26.02.2026

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Sajt”, si dhe në Vendimin e KKTKM-së, Nr. 75 datë 19.02.2020 “Për miratimin e llojeve të ndërhyrjeve me karakter mirëmbajtës të pasurive kulturore, sipas listës bashkëlidhur”, i ndryshuar, pas shqyrtimit të projektit, në mbledhjen e datës 26.02.2026, Këshilli Teknik:

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Mbulim me çati për termoizolim dhe hidroizolim në objektin me numër pasurie 266 në zonën kadastrale 1481, me pronar Petro Gjipopulli”, Brenda Kufirit Zonë e Mbrojtur e Qendrës Historike të fshatit Dhërmi, me aplikues Znj. Alda Yzeiraj dhe zhvillues **Z. Petro Gjipopulli**;
2. Subjekti zhvillues të vijojë me procedurën ligjore për miratim sipas Ligjit Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
4. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
5. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I KT
Endri HAXHIU